

Dija, Liria, dhe Vlera si Koncepte të Munguara dhe të Keqkuptuara në Shoqërinë Shqiptare

Viliem Kurtulaj, PhD.

Qendra e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Inovacionit

Kolegji Universitar i Biznesit

Email: viliemkurtulaj@gmail.com

Abstrakt

Në fokus të këtij artikulli janë tre koncepte kryesore: *dija*, *liria*, dhe *vlera*. Për një shoqëri, është thelbësore se mbi cilat koncepte dhe parime ajo ngre ekzistencën dhe vizionin e vet. Edhe pse jeta e përditshme e pjesëtarëve të një shoqërie është thelbësisht praktike, është e vështirë të gjesh një shoqëri të zhvilluar dhe demokratike që mos të mishërojë parimet dhe teoritë ku janë të ndërthurura ato vlera që kanë sjellë përparimin e asaj shoqërie. Mënyra se si i kuptojmë konceptet përcakton se si ne i respektojmë ato. Për këtë arsye, është e rëndësishme të kuptojmë se si shoqëria shqiptare i percepton koncepte të tilla si dija, liria, vlera, etj.; si ndërvepron me këto koncepte; dhe si lidhen këto koncepte me njëri-tjetrin. Ky punim përdor metoda cilësore dhe sasiore, respektivisht rishikim të literaturës së filozofëve të tillë si Foucault dhe Kant, e cilat lidhet me konceptet e sipërpërmendura, si dhe pyetësorë me të rinj shqiptarë (studentë të vitit të parë) në lidhje me sistemin e tyre të vlerave. Nga rezultatet, vihet re se rinia shqiptare prirët të konsiderojë vlerë kryesisht të mirat materiale dhe vlerat tradicionale familjare. Por ajo ka mungesë konceptuale dhe nivel të ulët të përthithjes së vlerave universale qytetare, edukative dhe morale. Kjo lidhje e dobët me këto vlera është një nga shkaktarët e gjendjes aktuale sociale, politike, dhe ekonomike të shoqërisë shqiptare në tërësi.

Fjalë kyçe: dije, liri, vlerë, shoqëri, Shqipëri.

Qëllimi i këtij artikulli është të kuptojë se si qëndrojnë konceptet e dijës, lirisë, dhe vlerës në një kontekst të caktuar, siç është shoqëria shqiptare. Gjithashtu, artikulli tenton të zbërthejë sistemin e vlerave që kanë të rinjtë shqiptarë sot. Koncepti i dijës në këtë punim ka kryesisht kuptim *fukodian* (Michel Foucault). Dija nuk nënkupton vetëm njohuri formale që mund të prodhohen me metoda të përcaktuara në institucionet shkencore, por të gjithë gamën e njohurive që mund të prodhohen nga çdo agjent apo institucion në shoqëri. Dija mund të prodhohet në mënyra të ndryshme. Dija prodhon pushtet dhe pushteti mund të prodhojë dije (Foucault, 2009). Kjo do të thotë se ajo që unë po bëj përmes këtij artikulli është *nolens volens* jo vetëm një prodhim dijeje, por edhe një ushtrim pushteti, sado i vogël që të jetë. Është e vështirë të provosh atë që Foucault pretendonte, se çdo diskurs prodhon pushtet, por jam i bindur që diskurset prodhojnë pushtet. Dikush mund të thotë se ka pushtete që nuk prodhohen fare nga diskurset, por nga forca. Në fakt, ekzistojnë disa përkufizime në lidhje me termin "pushtet", të cilat ndryshojnë nga njëri-tjetri. Siç e përmenda më lart, në këtë punim, koncepti "pushtet" ka kuptimin *fukodian*. *Tipari i veçantë i pushtetit qëndron në faktin se disa njerëz mund të përcaktojnë në mënyrë pak a shumë të plotë sjelljen e njerëzve të tjerë – pak a shumë, porse kurrë krejtësisht dhe as nëpërmjet forcës. Njeriu i rrahur e i lidhur me pranga i nënshtrohet, sigurisht, forcës që ushtrohet mbi të. Forcës, por jo pushtetit.* (Foucault, 2009, f. 157). Një tipar tjetër i pushtetit është se ai gjendet kudo, sepse pushteti mund të prodhohet në çdo kohë, në çdo pikë brenda çdo marrëdhënieje. Marrëdhëniet e pushtetit mund të shihen si një rrjet, ku pikat nga ku ushtrohet pushteti mund të jenë kudo, dhe pikat mbi të cilat ushtrohet pushteti mund të jenë gjithashtu kudo. Siç thotë Foucault, *pushteti është kudo... sepse vjen nga të gjithandej* (2011, f. 123). Liria nga ana tjetër është e rëndësishme për marrëdhënien që krijon shoqëria me pushtetin. Ndërsa vlera ka rëndësi thelbësore sepse

orienton dhe shpjegon përdorimin që ne i bëjmë dijes, pushtetit, dhe lirisë.

Dija në Shoqërinë Shqiptare

Nuk marr përsipër ta konsideroj të veçantë apo unike raportin e shoqërisë shqiptare me dijen, lirinë, dhe vlerat e as ta përgjithësoj atë me shoqëri dhe kultura të tjera. Ndoshta shoqëritë me karakteristika të ngjashme prodhojnë marrëdhënie të ngjashme me këto koncepte. Kjo mund të shkaktohet sepse kur diskursi institucionalizohet në shoqëri, ai prodhon të vërteta për të gjithë shoqërinë dhe çdo e vërtetë shoqërohet me pushtet. Sipas Foucault (2009), në çdo shoqëri marrëdhëniet e shumëfishta të pushtetit përshkojnë, depërtojnë, karakterizojnë dhe formësojnë trupin shoqëror. Si të tilla, ato nuk mund të ndahen, as të zhvillohen, as të funksionojnë pa prodhimin, akumulimin, qarkullimin dhe funksionimin e një diskursi me pretendim të së vërtetës. Nuk ka funksionim të pushtetit pa një ekonomi të caktuar të diskurseve të vërteta, të cilat veprojnë brenda këtij pushteti, të nisur prej tij dhe nëpërmjet tij. Pushteti nuk mund të ushtrohet, përveçse duke prodhuar vërtetësi ose të vërtetat e veta. Këto të vërteta mund të prodhohen nga individë ose institucione. Më poshtë shohim një pasazh të Foucault-së që tregon marrëdhënien e njeriut me dijen dhe pushtetit.

Njeriu është njëherësh objekt dhe subjekt i dijes, ose më saktësisht: njeriu është një subjekt, i cili, subjektin e vet e merr si objekt të dijes.... Pushteti ushtrohet mbi njeriun si objekt... vetëm përta arrin ta prodhojë atë si subjekt. (Foucault, 2011, f. 17).

Një element tipik që vihet re lehtësisht në shoqërinë shqiptare, në raportin e saj me dijen, është se “të gjithë dinë gjithçka”. Më duhet të sqaroj se kur flas për shoqërinë shqiptare dhe raportin e saj me dijen apo vlerat kam parasysh shoqërinë në përgjithësi, duke pranuar përjashtimet që sigurisht ekzistojnë. Kjo është lehtësisht e konstatueshme. Për shembull, mjafton të dalësh në rrugë dhe të pyesësh njerëzit, p.sh. për politikën apo marrëdhëniet ndërkombëtare. Ka të ngjarë të mos marrësh asnjë përgjigje "Nuk e di!". Pothuajse të gjithë përgjigjen duke pretenduar se kanë dije të mjaftueshme për një temë që mund të mos ketë asnjë lidhje me interesat e tyre studimore, profesionale apo intelektuale. Nëse ky shembull është i pamjaftueshëm ose ndoshta i rastësishëm, le të ndezim televizorin në kanalet shqiptare. Janë të njëjtët persona që çdo mbrëmje diskutojnë nëpër studio televizive për lloj-lloj temash. Këta njerëz “japin mend” për politikën, ekonominë, sportin, astronominë, kriminologjinë, diplomacinë, modën, gastronominë, turizmin, seksin, mjekësinë, letërsinë etj. Me sa duket, askush nuk e refuzon ftesën për t'u shfaqur në televizion apo në ndonjë media apo hapësirë tjetër të mundshme publike për të folur. Çështja është se të gjithë mohojnë të thonë “nuk e di!”.

Në fakt, nëse në studiot televizive do të ftoheshin dhe do të shfaqeshin vetëm persona që përfaqësojnë zyrtarisht pushtetin (organet qeveritare, partitë politike), ndoshta shoqëria do të krijonte lehtësisht përshtypjen se agjenda mediatike është e diktuar nga pushteti. Rrjedhimisht, media do të humbiste besueshmërinë. Për të shmangur apo parandaluar këtë situatë, në studiot televizive dhe media të tjera, shfaqen ata që njihen si analistë. Këta analistë pretendojnë se janë të pavarur dhe në një farë mase përfaqësojnë opinionin, shqetësimin, zërin, ose interesin publik. Për më tepër, këta analistë janë pothuajse të njëjtët persona kudo në media, dhe në total janë jo më shumë se një duzinë. Shpesh, ata mbrojnë në mënyrë indirekte interesat e një organi pushteti, siç mund të jetë një parti politike, një kompani biznesi, një institucion qeverisës, etj., nën “petkun” e dikujt që nuk ka lidhje (formale) me atë për të cilën flasin. Në rastin më të mirë, nëse e marrim si të mirëqenë pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre, ata sërish dëmtojnë përfaqësimin e interesit publik dhe krijimin e opinionit publik. Duke folur dhe shkruar për çdo temë, ata pretendojnë të jenë të gjithëditëshëm dhe, rrjedhimisht, shumica e analizave të tyre janë të dobëta dhe mediokre. Në këtë mënyrë kontribuojnë në desinformimin apo keqformimin e opinionit publik. Në fakt, problemi kryesor këtu qëndron diku tjetër. Duke qenë se janë i njëjti grup i vogël njerëzish që shfaqen kudo në media si përfaqësues të opinionit publik, në këtë mënyrë bëjnë privatizimin e diskursit publik. Interesi publik mund të privatizohet nëpërmjet

privatizimit të zërit të tij. Privatizimi i diskursit publik nga një grup i vogël njerëzish mund të bëjë që ky ligjërim të mos mbrojë më interesin publik, por ndonjë interes specifik privat apo partiak. Pra, kontradikta qëndron në faktin që privatizimi i zërit publik në media bëhet në emër të mbrojtjes së interesit publik.

Rastet e shembujve të sipërpërmendur kanë një arsye pse ndodhin, e cila i ka rrënjët e thella në kulturën e shoqërisë shqiptare. Po sjell këtu një shembull tjetër, të ngjashëm. Nëse dikush del në ndonjë qytet a fshat të Shqipërisë dhe pyet njerëz të rastësishëm se si mund të shkohet në një destinacion të caktuar, me siguri njerëzit do të përpiqen ta tregojnë edhe nëse nuk janë vetë të qartë. Sido që të jetë, ne (shoqëria shqiptare) e kemi shumë të vështirë të themi “nuk e di!”. Ky fenomen shkaktohet si pasojë e natyrës së raportit të shoqërisë shqiptare me dijen. Duket se marrëdhënia reale e shoqërisë shqiptare nuk është me vetë dijen, por me pretendimin për dije. Kjo ndodh sepse në këtë raport të shqiptarëve me dijen, është ngulitur ajo që quhet “moral”. Marrëdhënia e dijes me moralin brenda shoqërisë shqiptare kushtëzohet nga “turpi”. Por, ne si shoqëri, nuk na vjen turp që nuk dimë, sepse nëse do të kishim turp për këtë, do të përpiqeshim ta ndryshonim duke mësuar dhe përvetësuar ato gjëra për të cilat na vjen turp.

Të jesh *kantian* në ideologji do të thotë të ndjekësh disa parime, të cilat dalin nga vetëdija jonë e brendshme, pavarësisht nga çdo përvojë, interes, dëshirë apo gjendje e jashtme që mund të kemi për të kundërtën (Centre for the Study of Language and Information, Stanford University, 2016). Të sillësh sipas etikës kantiane do të thotë që veprimi yt është objektivisht i domosdoshëm në vetvete, pavarësisht nga raporti i tij me një qëllim të mëtejshëm. Kjo është ajo që quhet "Imperativ Kategorik" (Doody, 2014). Duke e konsideruar turpin si një term "*akantian*", ne e lidhim atë me reagimin e jashtëm të shfaqjes së vetes si të padijshëm. Pra, ne gënjejmë për të shmangur turpin që vjen nga të qenit i padijshëm para të tjerëve. Nuk e marrim parasysh faktin që lidhja e vërtetë me moralin qëndron në të mos gënjerit. Në të vërtetë, të gënjes për t'u dukur i ditur është imorale. Njerëzit në rrugë iu përgjigjen pyetjes sepse u vjen turp të duken të padijshëm, edhe nëse kjo ka koston e një gënjeshtre. Pra, në shoqërinë shqiptare, raporti “qytetar – dije” është në të vërtetë një raport “qytetar – turp (i jashtëm) – dije”. Duke iu përgjigjur pyetjes së bërë nga një person tjetër për drejtimin ose vendndodhjen "x", pa e ditur përgjigjen, ndoshta e gënjejmë duke e ngatërruar ose duke i treguar drejtimin e gabuar. Kjo do të thotë që për të shmangur çdo paraqitje si të padijshëm, plus, ndoshta, edhe dëshirën për të ndihmuar, ne bëjmë një veprim të pamoralshëm duke gënjer. Në këtë mënyrë, marrëdhënia jonë me moralin është e pasinqertë. Ne e lidhim moralin vetëm me marrëdhënien me subjektet e jashtme, duke përjashtuar veten. Duke mos pasur turp nga vetja, ne nuk e konsiderojmë veten subjekt por objekt pa mendim dhe personalitet. Morali apo turpi nuk ekziston për ne, pavarësisht gjithçkaje që mund të kemi bërë, për sa kohë që të tjerët nuk janë në dijeni. Kjo do të thotë se elementi i moralit në raportin e shoqërisë shqiptare me dijen qëndron vetëm në aspektin e paraqitjes si njeri i moralshëm, dhe jo në të qenit realisht i tillë. Mund të na vijë turp nga kushtdo përveçse nga vetja.

Rëndësia e të qenit i moralshëm para të tjerëve mund të kuptohet edhe nëpërmjet një shembull tjetër. Në shumë raste ky fenomen ushqen një fenomen tjetër në Shqipëri të quajtur gjakmarrje. Një pjesë e konsiderueshme e vrasjeve për gjakmarrje në Shqipëri bëhen sepse nëse familja nuk mund ta marrë gjakun e familjarit të vrarë, mund të turpërohet para të tjerëve, përpara bashkësisë/shoqërisë. Familja, në njëfarë mënyre, turpërohet nëse nuk e merr gjakun. Kryesisht në fshatra, ku zakonisht ndodh ky fenomen, familja që nuk e merr gjakun konsiderohet nga komuniteti përreth si një familje pa dinjitet, pa nder, pa moral, pa vlerë, e pa aftë, dhe që nuk meriton respekt. Familjes së cilës u është vrarë një pjesëtar, mund të mos besojë në vlerat e gjakmarrjes dhe mund ta konsiderojë të padrejtë marrjen e gjakut. Për ta, vrasja për të marrë gjakun mund të mos jetë vlerë. Ata, brenda vetes, edhe mund ta falin familjen tjetër për vrasjen e familjarit të tyre, por për të mos u turpëruar para të tjerëve dhe për t'u respektuar nga

shoqëria, familja “detyrohet” në njëfarë mënyre të vrasë për të marrë gjakun dhe për t’i kthyer në vend nderin dhe moralin familjes.

Liria si Tipar i Njeriut

Është e rëndësishme të theksohet se dukuritë e përmendura në seksionin e mëparshëm mund të rrjedhin nga fakti se kulturalisht shoqëria shqiptare nuk është ende një shoqëri e lirë. Në diskurin popullore, liria në përgjithësi konsiderohet ajo lloj lirie që i përshtatet më shumë natyrës shtazore sesa natyrës njerëzore. Nëse për krijesat e tjera në tokë, liria është mundësia e mbijetesës ose e lulëzimit kudo, kuptimi i lirisë për njerëzit është diçka tjetër, shumë më tepër se kaq. Liria e njeriut nuk është thjesht mundësia për të përmbushur dëshirat e veta, sepse dëshirat mund të jenë orekse dhe orekset janë të determinuara. Ajo që është e determinuar, është e përcaktuar dhe prandaj nuk mund të jetë në thelb e lirë. Liria e njeriut është pikërisht të kapërcesh determinimin, që do të thotë të kapërcesh dëshirat dhe orekset. Orekset mund të jenë dëshira ose nevoja biologjike. Dëshira për t’u ushqyer mirë, për të bërë seks, për të pasur një jetë komode plot kënaqësi dhe dëfrim janë të njëjtat dëshira që mund t’i ketë edhe një kafshë. Por liria e njeriut nuk mund të krahasohet apo barazohet me lirinë e krijesave të tjera siç janë kafshët.

Njeriu është i lirë kur kërkon dhe vepron përtej dëshirave të veta, edhe kur këto veprime mund t’i kundërvihen orekseve të tij. Njeriu është një qenie vepruese në botë sepse është i lirë. Njeriu është krijues në botë. Njeriu e bën botën edhe duke mohuar veten, shoqërinë, natyrën, etj. Kur njeriu nuk ka asgjë më për të mohuar, ai barazohet me veten (Feraj, 2011). Si rezultat i dy karakteristikave të ndryshme thelbësore, të lirisë që kanë kafsha dhe njeriu, ose më mirë mosliria e kafshës dhe liria e njeriut, kafsha i përshtatet botës, ndërsa njeriu e bën botën. Kafsha është pasive në botë; njeriu është aktiv në botë (Heidegger, 1983). Rrjedhimisht, sa më shumë një person përshtatet me botën, pa tentuar ta “bëjë” botën, aq më pak subjekt është.

Për shkak se njeriu është një qenie me mendim dhe nuk vepron vetëm instinktivist, ne mund ta shohim atë si një projekt në botë; si projekt për të realizuar veten dhe botën; si një projekt që bën histori dhe jo vetëm i përshtatet historisë. Që një njeri të jetë, ai duhet të jetë “i lirë” sipas konceptit të lirisë që parashtrova më sipër. Mirëpo, njeriu, jo rrallë herë, nuk mund ta përmbushë këtë koncept të lirisë pa mohimin e vetvetes. Pra, të jesh i lirë është aftësia, guximi, vullneti për të thënë “jo” kur është e nevojshme dhe për të vepruar në përputhje me këtë. Njeriu i thotë “jo” (e mohon) natyrës, objekteve dhe subjekteve që e rrethojnë; i thotë “jo” sistemeve të ndryshme politike dhe ekonomike; dhe mund të shkojë aq larg sa të mohojë veten dhe të kryejë vetëvrasje. Një kafshë nuk mund të mohojë veten dhe të bëjë vetëvrasje. Edhe akrepat, të cilët mendoheshin se kryejnë vetëvrasje, nuk e bëjnë një gjë të tillë sepse janë imun ndaj helmit të tyre (Cobb, 2010). Kafshët nuk mund të bëjnë greva urie apo të bëjnë vetëvrasje sepse nuk e mohojnë vetveten. Mohimi i vetvetes është një veprim që shkon përtej natyrës së lirisë së kafshëve.

Njeriu, si modus nuk përkufizohet vetëm me bashkimin dhe lidhjen e një shpirti me një trup, ideja e të cilit ai është, por edhe me fuqinë e shprehjes dhe të prodhimit që përbën këtë modifikim. Pra, njeriu nga një njeri tjetër ndryshon përmes fuqisë me të cilën ai zhvillon format e shprehjes së veprimeve dhe mendimeve të veta; me mënyrat e përjetimit të dukurive të natyrës dhe të shoqërisë; dhe me mënyrën se si ai shpreh atë që përjeton trupi dhe mendja e tij (Kullashi, 2005).

Analizë e Perceptimeve mbi Vlerat në Rininë Shqiptare

Dija shpesh herë fitohet ose orientohet nga çfarë njerëzit konsiderojnë vlerë. Liria gjithashtu përdoret nga njerëzit sipas vlerave që ata kanë. Për të kuptuar se si është raporti i të rinjve shqiptarë me dijen, dhe nga cilat parime udhëhiqen ata në përdorimin e lirisë që kanë, unë realizova një pyetësor me studentët e vitit të parë të Kolegjit Universitar të Biznesit (Tiranë).

1. Metodologjia

Gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2024–2025, u realizua një pyetësor me 84 studentë të vitit të parë në Kolegjin Universitar të Biznesit, përfshirë studentë të programeve bachelor dhe studimeve të larta profesionale. Pyetësi përmbante një pyetje të vetme, të hapur:

"Çfarë është vlerë për ju?"

Studentët mund të jepnin më shumë se një përgjigje. Për këtë pyetësor janë përzgjedhur vetëm studentë të vitit të parë, për të kuptuar sistemin e tyre të brendshëm të vlerave në fazën e tranzicionit nga adoleshenca në moshën madhore. Përgjigjet e studentëve janë bërë me shkrim, dhe janë realizuar të gjitha në mjediset e institucionit.

2. Profili i kampionit

Kampioni përfshin 84 studentë nga zona dhe fasha të ndryshme sociale-ekonomike, gjë që ofron një diversitet përfaqësues për të rinjtë shqiptarë të kësaj moshe.

3. Rezultatet kryesore

Tabelat e mëposhtme tregojnë se çfarë konsiderojnë si vlerë të rinjtë shqiptarë nga ky pyetësor. Secila tabelë shoqërohet nga një paragraf i shkurtër shpjegues.




Tabela 1.

Përgjigjja më shpeshtë e të studentëve të pyetur ka qenë “paraja”, e përmendur si vlerë nga 21 studentë. “Familja” është përmendur nga 20 studentë si vlerë. Edhe “morali dhe ndershmëria” konsiderohen si vlerë nga 20 studentë të pyetur. Ndërsa 18 nga 84 studentë të pyetur nuk arrijnë të kuptojnë pyetjen dhe, rrjedhimisht, nuk arrijnë t’i përgjigjen asaj.




Tabela 2.

Në tabelën 2 vihet re se aspekte të tjera të qytetarisë konsiderohen si vlera nga studentët e

pyetur, edhe pse jo në masë prej tyre. 12 persona janë përgjigjur se “kultura” është vlerë për ta. Po 12 është numri i atyre që konsiderojnë “respektin” si vlerë. “Mirësjellja” është përmendur si vlerë nga 11 studentë të pyetur, ndërsa 10 prej tyre konsiderojnë “shoqërinë” si vlerë.




Tabela 3.

Tabela 3 tregon se “besueshmëria” është një tjetër vlerë e përmendur nga 8 të pyetur. Edhe “mirësia” konsiderohet vlerë nga 8 persona. 6 studentë kanë thënë se, për ta, “dashuria” është vlerë. “Emocionet dhe ndjenjat” konsiderohen vlerë nga 5 të pyetur.




Tabela 4.

“Edukimi dhe arsimi” përmenden si vlerë nga vetëm 5 studentë. “Dija” gjithashtu përmendet nga 5 studentë. “Empatia” konsiderohet vlerë nga 3 të pyetur. “Përmbushja e brendshme” përmendet si vlerë nga 3 studentë.




Tabela 5.

“Komunikimi” konsiderohet vlerë nga 3 studentë. Edhe “drejtësia” konsiderohet nga 3 studentë si vlerë. “Të qenit i rëndësishëm” është vlerë për 2 studentë të pyetur. Edhe “mirëqenia” konsiderohet vlerë nga vetëm 2 studentë.




Tabela 6.

Siç tregon tabela 6, tipare të tilla si “liria”, “cilësia”, “tradita”, “dobishmëria”, “sjellja qytetare” konsiderohen si vlera vetëm nga 2 studentë të pyetur.

Të bërit qejf	1
Vetëpërmirësimi	1
Shëndeti	1
Të qenit vetvetja	1
Të ndjekësh endërrat	1
Intelekti	1
Vizioni	1
Ambicja	1
Puna	1
Ndihma e ndërsjellë	1
Identiteti	1
Koherenca	1
Devotshmëria	1
Mënyra e veshjes	1
Dinjiteti	1
Përgjegjësia	1
Karakteri	1

Tabela 7.

Në tabelën 7 janë të shfaqura të gjitha përgjigjet e tjera të përmendura si vlerë vetëm 1 herë nga studentët e pyetur.

4. Analiza e Përgjigjeve mbi Perceptimin e Vlerave të Rinjtë Shqiptarë (rreth 18 vjeç)

1. Dominimi i vlerave materiale dhe familjare

- **“Paraja”** është përmendur si vlerë më shumë se çdo vlerë tjetër (nga 21 studentë), duke treguar një orientim të qartë të një pjese të mirë të të rinjve drejt **aspekteve materiale dhe të suksesit financiar**.
- Menjëherë pas saj vijnë **“familja”** (20) dhe **“moralit e ndershmëria”** (20), çka tregon se pavarësisht presioneve ekonomike, **struktura tradicionale dhe etika personale** kanë ende një peshë të rëndësishme në vetëdijen e të rinjve shqiptarë.

2. Ndikimi i ambientit socio-ekonomik dhe edukativ

- Përmendja e **parave**, por edhe përmendja e ulët e vlerave si **edukimi, dija apo mirëqenia**, sugjerojnë se **prioritetet e studentëve janë të ndikuara nga vështirësitë reale ekonomike dhe nga mungesa e një qasjeje më të thellë filozofike apo qytetare ndaj konceptit të “vlerës”**.
- Vetëm **5 studentë**, nga 84 të tillë, përmendin **“arsimin”** dhe **“dijen”** si vlera, që për një kontekst universitar përbën një sinjal shqetësues mbi mungesën e përbrendësimit të edukimit si vlerë në vetvete.

3. Vlerat e qytetarisë dhe ndjeshmërisë sociale janë të marginalizuara

- Vlera si **empatia, drejtësia, komunikimi, sjellja qytetare** apo **tradita** përmenden në nivele shumë të ulëta.
- Kjo mund të jetë pasojë e një mungese të edukimit qytetar, të debatit kritik në shkollat e mesme, ose një reflektim i realitetit ku këto vlera nuk perceptohen si efektive apo të shpërblyera.

4. Paqartësi konceptuale dhe mungesë reflektimi

- Një numër domethënës studentësh (**18 nga 84**, pra mbi 21%) **nuk arrijnë të kuptojnë pyetjen**, gjë që tregon ose paaftësinë për të artikuluar një koncept abstrakt, ose mungesën e ekspozimit ndaj temave të tilla gjatë arsimit parauniversitar.
- Ky fakt është veçanërisht i rëndësishëm për mësuesit, edukatorët dhe politikatat arsimore: **nëse të rinjtë nuk kuptojnë çfarë është një "vlerë", ata janë të pambrojtur nga manipulimi ideologjik apo konsumizmi ekstrem.**

5. Shpërndarja e moderuar e vlerave shoqërore

- Vlera si **respekti, mirësjellja, shoqëria, besueshmëria e mirësia** marrin përgjigje mesatare (nga 8 deri në 12 përmendje).
- Kjo tregon se ndërgjegjja morale dhe raportet ndërpersonale kanë një **vlerësim të pranishëm, por jo qendror**, në sistemin e vlerave të të rinjve shqiptarë.

6. Vlerat personale dhe psikologjike: të pranishme, por në minorancë

- Disa studentë përmendin vlera si **dashuria, emocionet, përmëshja e brendshme**, që janë më tepër vlera personale dhe ekzistenciale. Megjithatë, numri i ulët i përmendjes tregon që **reflektimi mbi mirëqenien psikologjike apo zhvillimin personal është ende në hapat e parë** në këtë grupmoshë.

Përfundime

Dija dhe sistemi i vlerave përcaktojnë në një farë mënyre se si funksionon një shoqëri dhe si ushtrohet pushteti nga anëtarët e asaj shoqërie. Njeriu është mbartës i vlerave të cilat e orientojnë në veprimet e tij. Ai është, në të njëjtën kohë, subjekt dhe objekt i dijes, dhe rrjedhimisht i pushtetit. Marrëdhënia e dijes me moralin brenda shoqërisë shqiptare është e kushtëzuar nga "turpi". Por, ne si shoqëri, nuk turpërohemi ngaqë nuk dimë, sepse nëse do të turpëroheshim nga kjo, do të përpiqeshim ta ndryshonim atë dhe të mësonim ato gjëra për të cilat turpërohemi. Pra, nuk turpërohemi nga vetja, por nga të tjerët. Shoqëria shqiptare e lidh moralin vetëm me marrëdhënien me subjektet e jashtme, duke përjashtuar veten. Duke mos pasur turp nga vetja, ne nuk e konsiderojmë veten subjekt, por objekt në një farë mënyre. Elementi i moralit ndërmjet shoqërisë shqiptare dhe dijes qëndron vetëm në aspektin e shfaqjes si një person i moralshëm, dhe jo të qenit realisht i tillë. Ne mund të turpërohemi nga kushdo përveç vetes.

Liria e njeriut nuk është thjesht mundësia e përmëshjes së dëshirave të veta, sepse dëshirat mund të jenë orekse, dhe orekset janë të përcaktuara. Ajo që është e përcaktuar, nuk mund të jetë në thelb e lirë. Liria e njeriut është pikërisht kapërcimi i përcaktimit, që do të thotë kapërcimi i dëshirave dhe orekseve. Njeriu është i lirë kur kërkon dhe vepron përtej dëshirave (orekseve) të veta, edhe kur këto veprime mund të bien ndesh me orekset e veta. Njeriu nuk mund ta përmëshjë konceptin e lirisë pa mohimin e vetvetes. Njeriu është i lirë për aq sa mund ta mohojë veten dhe të jetë krijuar në botë.

Mikronarrativa, gjatë epokës komuniste (1945-1991) në Shqipëri, lejohej për aq sa nuk kërcënonte metanarrativën - e cila përfaqësohej nga pushteti - por indirekt, tregonte madhështinë e saj. Gjatë epokës komuniste, puna erudite në Shqipëri u kthye plotësisht në shërbim të pushtetit, në shërbim të diskursit mbizotërues. Shumë "të vërteta", kryesisht ideologjike, vendoseshin nga partia dhe shkencëtarët kishin vetëm një detyrë t'i provonin ose justifikonin ato. Diskurset dhe njohuritë e skualifikuara, të cilat qarkullonin në shoqërinë shqiptare në periudhën 1945-1990, u shtypën gjithashtu deri në atë pikë sa nuk përbënin

kërcënim për pushtetin dhe nuk kishin forcë t'i kundërviheshin atij.

Në sistemet demokratike, pushteti nuk mund të ketë kontroll të plotë mbi institucionet e dijeve, veçanërisht mbi universitetin, prandaj nuk mund ta përdorë atë drejtpërdrejt për qëllime propagandistike. Në këtë drejtim, pushteti është më i interesuar t'i mbajë universitetet të heshtura në prodhimin e të vërtetave që mund të vënë në dyshim ose të tronditin të vërtetat e pushtetit. Pra, propaganda më e mirë për pushtetin, në këto raste, është heshtja e universitetit.

Sa i përket sistemit të vlerave të rinjve (rreth 18 vjeç) shqiptarë sot del në pah një **përzierje midis vlerave tradicionale familjare dhe një orientimi të qartë drejt sigurisë financiare. Ka mungesë konceptuale dhe nivel të ulët të përbrendësimit të vlerave qytetare, edukative dhe morale universale.** Për ta ndryshuar këtë panoramë, nevojiten:

1. **Fuqizimi i edukimit qytetar dhe etik në arsimin parauniversitar.**
2. **Zhvillimi i programeve të trajnimit për reflektimin mbi vlerat** në nivel universitar, sidomos për studentët e vitit të parë.
3. **Krijimi i hapësirave për debat dhe analizë kritike** nëpër auditorë mbi tema të tilla si: drejtësia, empatia, përgjegjësia, solidariteti.
4. **Studime të tjera më të thelluara** për të krahasuar perceptimin e vlerave sipas gjinisë, zonës së origjinës apo fushës së studimit.

Referenca

- Centre for the Study of Language and Information. (2016). 'Kant's Moral Philosophy', *Stanford University*. Available at: <https://plato.stanford.edu/entries/kant-moral/>
- Cobb, M. (2010). 'Do Animals Commit Suicide?', *Why Evolution Is True*. Available at: <https://whyevolutionistrue.wordpress.com/2010/03/23/do-animals-commit-suicide/>
- Doody, R. (2014). *Kantian Ethics: the categorical imperative*. Massachusetts: Massachusetts Institute of Technology
- Feraj, H. (2011). *E Pafilozofuara*. Tirana: Zenit
- Foucault, M. (2009). *Pushteti dhe Dija*. Tirana: ISP & Dita 2000
- Foucault, M. (2011). *Historia e Seksualitetit 1*. Tirana: UET Press
- Heidegger, M. (1983). *Die Grunbegriffe der Metaphysik* [Leksionet e semestrit dimëror në Freiburg 1929/30], GA, pp. 29-30
- Kant, I. (2004). *Themelimi i Zakoneve Shoqërore*. Tirana: Botimet Dritan
- Kullashi, M. (2005). *Mendimi Politik Modern*. Prishtina: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës